



Republika e Kosovës
Republic Kosovo - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtine
Opština Pristine - Municipality of Prishtine



Drejtoria e Financave

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE

2024-2026

Përmbajtja

Korniza afatmesme buxhetore komunale	3
Objektivat e Kornizës afatmesme buxhetore komunale.....	4
Objektivat e Komunës së Prishtinës	4
Objektivat e Qeverisë së Kosovës	4
Objektivat dhe përfitimet e procesit të KAB-së për komunat	5
Objektivat	6
Struktura organizative e Komunës së Prishtinës	7
Programet.....	8
Pjesëmarrja e programeve buxhetore në grantin qeveritar 2024-2026.....	11
Perspektiva e politikave fiskale	11
Pjesëmarrja e granteve në buxhet, sipas viteve, 2024 – 2026	11
Parashikimi i të hyrave vetanake komunale	12
Plani i të hyrave vetanake komunale 2024 – 2026	14
Vlerësimet e hershme të shpenzimeve të programeve buxhetore	16
Grantet qeveritare dhe të hyrat vetjake 2024 – 2026.....	16
Buxheti 2024-2026 dhe deklaratat e misioneve dhe vizioneve sipas programeve buxhetore - drejtorive	17

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2024 - 2026

Korniza afatmesme buxhetore e Komunës së Prishtinës, është dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, që do të pasqyrojë caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike, për të përmbushur objektivat e përcaktuara me Strategjinë zhvillimore afatmesme komunale. Si pjesëpërbërëse e Kornizës afatmesme buxhetore (KAB), është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2024/2026, të dhëna nga Ministria e Financave (MF), përmes Qarkores buxhetore 2024/01 për komunat, si dhe financimi nga grantet qeveritare dhe kufijtë fillestarë të buxhetit komunal për vitin 2024 dhe parashikimet për periudhën 2025 - 2026, që janë miratuar nga Komisioni i granteve, si pjesë integrale e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) 2024/2026, e miratuar nga Qeveria e Kosovës, më 15 maj 2023.

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit, që bën ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e Komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare. Me Kornizën afatmesme buxhetore – komunale, do t'i paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioriteteteve të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Prishtinës, si dhe projeksionet lidhur me mënyrën, me të cilën buxheti i Komunës do t'i përmbushë dhe përkrahë projektet me prioritet, që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2024/2026, gjithnjë duke u bazuar në:

- Ligjin për financat e pushtetit lokal;
- Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;
- Ligjin për vetëqeverisjen lokale;
- Ligjin për kufijtë administrativë komunalë.

OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2024-2026, planifikohet në bazë të buxhetit, i cili bazohet në Buxhetin e programeve, në objektivat dhe në deklaratat e misioneve të programeve. KAB-ja komunale 2024-2026, është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores buxhetore nr. 2024/01, e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve. Në KAB-në komunale paraqiten edhe deklaratat dhe misionet e drejtorive lidhur me punën e tyre pasuese trevjeçare.

❖ Objektivat e Komunës së Prishtinës:

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së qytetit;
- Menaxhimi i arkëtimit të mbeturinave, duke ndihmuar ndërmarrjen publike për pastrim;
- Hartimi i planit zhvillimor komunal dhe planeve rregulluese në zonat urbane;
- Zhvillimi i fushës së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
- Përfshirja e tërësishme në arsim parashkollor, fillor dhe të mesëm, si dhe ngritja e nivelit të arsimit;
- Zhvillimi i fushës së kulturës, rinisë dhe sportit;
- Promovimi dhe përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme;
- Përkrahja e të rinjve dhe ulja e papunësisë;
- Zhvillimi i turizmit kulturor, historik dhe malor;
- Subvencionimet në bujqësi;
- Përkrahja e OJQ-ve në përgjithësi, e në veçanti organizatat e të rinjve.

❖ Objektivat e Qeverisë së Kosovës:

- Rritja dhe qëndrueshmëria ekonomike;
- Punësimi dhe mirëqenia;
- Sundimi i ligjit dhe shteti ligjor;
- Integrimet evropiane, politika e jashtme dhe çështjet e sigurisë;
- Arsimi, shkenca, kultura, rinia dhe sporti;
- Shëndetësia moderne.

❖ Objektivat dhe përfitimet e procesit të KAB-së për komunitat

Inkorporimi i qasjes së KAB-së në proceset e buxhetit komunal, është i motivuar nga qëllimet e mëposhtme:

- Të ofrojë kornizë gjithëpërfshirëse dhe reale për planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore për tri vitet e ardhshme;
- Të rrisë parashikimin dhe qëndrueshmërinë e planifikimit të buxhetit, përmes futjes së parashikimit më të besueshëm të të hyrave komunale dhe shpenzimeve në perspektivë trevjeçare;
- Të përmirësojë lidhjen në mes procesit të alokimit të burimeve dhe prioriteteve të politikave komunale;
- Të fuqizohen drejtoritë komunale në shpërndarjen e burimeve, menaxhim dhe shfrytëzim;
- Të bëhet planifikimi sa më objektiv nëpër kategori ekonomike – BDMS;
- Të bëhet alokimi i mjeteve buxhetore për vitet e ardhshme sipas kategorive ekonomike;
- Planifikimi i investimeve kapitale përmes sistemit të PIP-së;
- Përfshirja e buxhetit gjinor në të gjitha fushat, si një implementim i nevojshëm për të garantuar parimin e barazisë gjinore.

Objektivat:

a) Shtimi i efikasitetit dhe efektivitetit:

Përmirësimi i efektivitetit në shpenzimin e buxhetit komunal;

- Planifikimi i buxhetit në kode dhe nënkode ekonomike;
 - Shfrytëzimi maksimal i burimeve;
 - Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve;
 - Kryerja e punëve në mënyrë të duhur dhe cilësore;
- Përzgjedhja e punëve me prioritet për realizim.

b) Rritja e të hyrave vetjake:

- Rritja e efikasitetit në arkëtim;
- Mundësia për zbatimin e tarifave të reja.

c) Kontrolli dhe reduktimi i shpenzimeve

- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme;
- Planifikimi i shpenzimeve me kohë;
- Përparësia nga blerja me shumicë;
- Përmirësimi i performancës për mallra dhe shërbime;
- Planet për kursim nga shpenzimet – kontratat kornizë.

d) Ngritja e kapaciteteve njerëzore

Trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore;

Përdorim i software-ve të avancuar për shërbime;

Profesionalizimi i shërbimeve.

e) Sigurimi i disiplinës financiare:

- Harmonizim me politikat financiare, ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative;
- Ekzistenca e kontrolleve interne – auditori i brendshëm dhe zbatimi i rekomandimeve;
- Transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik;
- Analiza të vazhdueshme dhe sipas kërkesave të shpenzimeve;

- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë së gatshme (Kesh plani);
- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit sipas programit të BDMS – SZHMB;
- Planifikimi dhe realizimi investimeve kapitale sipas programit të PIP-së (Programi i investimeve publike);
- Respektimi i Ligjit të buxhetit - mos hyrja në obligime pa mbulesë - zotim të mjeteve.

f) Ekonomia:

- Zhvillimi i Strategjisë komunale për promovim ekonomik;
- Krijimi i kushteve të përshtatshme për donatorë të brendshëm dhe të jashtëm;
- Strategjia për zhvillimin rural;
- Strategjia për biodiversitet;
- Menaxhimi i mbeturinave.

Struktura organizative e Komunës së Prishtinës

616	KOMUNA E PRISHTINES	
1.1	160	Zyra e Kryetarit
1.1.1	16006	Zyra e Kryetarit
1.2	169	Zyra e Kuvendit të Komunës
1.2.1	16906	Zyra e Kuvendit të Komunës
1.3	163	Administrata dhe Personeli
1.3.1	16306	Administrata
1.4	166	Inspektimet
1.4.1	16611	Inspektimet
1.5	167	Prokurimi
1.5.1	16730	Prokurimi
1.6	175	Buxheti dhe financat
1.6.1	17506	Buxheti
1.6.2	17581	Tatimi ne Prona
1.7	180	Shërbimet publike, Mbrojtja civile, Emergjencia
1.7.1	18040	Investimet kapitale dhe menaxhimi i kontratave
1.7.2	18166	Infrastruktura publike
1.7.3	18230	Drejtoria e sigurisë dhe emergjencave, zjarrfikësit dhe inspektimet
1.7.4	18039	Menaxhimi i parqeve dhe hapësirave publike

1.8	195	Zyra komunale për komunitete dhe kthim
1.9	470	Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural
1.9.1	47006	Bujqësia
1.10	480	Zhvillimi ekonomik
1.10.1	48006	Planifikimi i zhvillimit ekonomik
1.11	650	Kadastru dhe gjeodezia
1.11.1	65030	Shërbimet kadastrale
1.12	660	Planifikimi urban dhe mjedisi
1.12.1	66335	Planifikimi urban dhe inspeksioni
1.13	730	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale
1.13.1	73015	Administrata
1.13.2	73350	Shërbimet e shëndetësisë primare
1.14	755	Shërbimet sociale
1.14.1	75526	Shërbimet sociale
1.14.2	75527	Shërbimet rezidenciale
1.15	850	Kultura, rinia dhe sportet
1.15.1	85006	Shërbimet kulturore
1.15.2	85086	Sporti dhe rekreacioni
1.16	920	Arsimi dhe shkenca
1.16.1	92030	Administrata
1.16.2	92310	Arsimi parashkollor dhe çerdhet
1.16.3	93150	Arsimi fillor
1.16.4	94350	Arsimi i mesëm

Programet:

a. Shqyrtimi dhe përmirësimi i sistemeve operative dhe transparenca:

- Respektimi i procedurave të prokurimit;
- Evidenca e duhur financiare dhe procedurat e kontabilitetit;
- Inventarizimi i duhur dhe menaxhimi i pronës;
- Koordinimet në mes drejtorive – programeve buxhetore;

- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe analizat;
- Menaxhimi i bazës së të dhënave;
- Informimi publik.

b. Përmirësimi i bazës së të hyrave vetjake komunale:

- Rritja e performancës së arkëtimit të tarifave dhe taksave komunale;
- Regjistrimi i tatimpaguesve të rinj për tatimin në pronë;
- Tarifa (ngarkesa) të reja për shërbime të reja;
- Tarifa (taksa) ekonomikisht të arsyetuara; -
- Ngarkesa të reduktuara (periodike).

Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat:


- Kontrolli për parandalimin e ndërtimit ilegal të shtëpive dhe objekteve të tjera;
- Procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje;
- Zbatimi dhe respektimi i rregulloreve komunale;
- Shqyrtimi i Planit të punës 2024;
- Përgatitja e buxhetit dhe planit të punës për vitin 2024;
- Përgatitja e Kornizës afatmesme buxhetore 2024-2026;
- Përgatitja e qarkoreve interne komunale;
- Mbajtja e dëgjimeve buxhetore me qytetarë;
- Përgatitja e planeve rregulluese dhe detaje;
- Përmirësimi i mbledhjes bazike të të dhënave dhe analiza e tyre;
- Shqyrtimi i përgjegjësive dhe i obligimeve komunale;
- Menaxhimi i projekteve;
- Menaxhimi i bazës së të dhënave;
- Monitorimi;
- Vlerësimi;

1.1. Korniza makroekonomike

Korniza makroekonomike është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas kritereve të Kornizës afatmesme buxhetore (KAB).

Pjesëmarrja e programeve buxhetore në totalin e grantit qeveritar 2024.

Komuna	Granti i përgjithshëm	Granti specifik për Arsim	Granti specifik për Shëndetësi	Ligji për Kryeqytet	Të hyrat vetjake	Gjithsej financimi 2024
Prishtinë	29,968,230	26,506,354	10,456,520	17,080,800	38,778,968	122,790,981



2. Pjesëmarrja e granteve në totalin e buxhetit, sipas viteve 2024 – 2026

2.1. Perspektiva e politikave fiskale

Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar politikave fiskale, politikës së të ardhurave, si nga granti i Qeverisë, të hyrave vetjake komunale dhe shpenzimeve. Me Kornizën afatmesme buxhetore 2024 – 2026, e cila është miratuar nga Qeveria e Kosovës, më 15.05.2023, bazuar në prioritetet afatmesme të Qeverisë dhe Kornizës makrofiskale 2024 -2026, Qeveria është përkushtuar që duke e ruajtur stabilitetin fiskal, të përkrahë edhe kërkesat e organizatave buxhetore, duke paraparë ndërmarrjen e një varg masash, që nga kursimet në kategorinë e shpenzimeve operative – si rezultat i rekomandimeve të FMN-së , e deri te marrja e masave konkrete në realizimin e të hyrave në nivel qendror dhe lokal, si:

- Kontroll më efikas dhe mbledhje e detyrueshme për ngarkesat dhe tarifatat e mbledhura në nivel lokal;
- Sensibilizim i qytetarëve për të kryer obligimet ndaj Komunës;
- Zyrrat komunale të tatimit në pronë, udhëzohen të bëjnë rekomandimet e tyre në vendosjen e zonave të vlerësimit të normave tatimore, nivelin e përpjekjeve në mbledhjen e tatimit në pronë, me qëllim të arritjes së të hyrave të planifikuara të tatimit në pronë të paraparë me projektbuxhet.

Parashikimi i të hyrave vetjake të Komunës së Prishtinës për periudhën 2024-2026

Të hyrat komunale të Komunës së Prishtinës realizohen në bazë të Ligjit mbi financat e pushtetit lokal, Rregullores mbi tarifatat dhe ngarkesat komunale, Rregullores mbi tatimin në pronë, si dhe dispozitave tjera ligjore, të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale, me të cilat Komuna ka të drejtë të caktojë dhe arkëtojë të hyra të tjera komunale.


Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë tatimi në pronë dhe të hyrat nga lejet e ndërtimit, të cilat të hyra duhet shpenzuar, dhe ekskluzivisht dedikohen në fushën e projekteve dhe investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime të tjera, gjë që ju kthehen qytetarëve (tatimpaguesve) në investime dhe ngritjen e infrastrukturës publike komunale.

Të hyrat e Komunës për periudhën 2024-2026, parashihet të arkëtohen nga:

- Tatimi në pronë
 - Tatimi në tokë,
 - Taksa për mbeturina,
- Taksa për leje ndërtimi,
- Taksa administrative komunale,
- Taksat për ushtrim të veprimtarisë afariste,
Taksat për lejen për shërbime profesionale,
Taksa për automjete motorike,
- Taksa nga kadastri dhe gjeodezia
- Taksa për certifikata,
 - Participim në Arsim,
 - Participim në Shëndetësi,
 - Të hyra të tjera.

KOMUNA	Taksat, ngarkesat dhe të hyrat tjera jo tatimore	Të hyrat nga tatimi në pronë	Projeksionet për vitin 2024
PRISHTINË	23,873,140	14,905,828	38,778,968

TE HYRAT VETJAKE TE KOMUNES SE PRISHTINES PER VITIN 2024



■ Taksat, ngarkesat dhe të hyrat tjera jo tatimore ■ Të hyrat nga tatimi në pronë

Taksa komunale për leje ndërtimi, është gjithashtu një kategori e rëndësishme e të hyrave. Gjatë planifikimit të kësaj të hyre, Komuna ende nuk është e sigurt me gjendjen e legalizimeve të objekteve të ndërtuara pa leje. Të gjitha objektet që nuk janë të legalizuara, por janë pjesë e planit urban, do të legalizohen, po ashtu me miratimin e Ligjit mbi tatimin në tokë, gjatë vitit 2024, të rritet arkëtimi i THV-së.

Me qëllim të rritjes së të hyrave vetjake, Komuna do të formojë një ekip për ngritjen e performancës së të hyrave vetjake për vitet e ardhshme.

Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale 2024 - 2026

Nr.	PËRSHKRIMI	2024	2025	2026
1	Taksa për leje ndërtimi	10,735,140.00	11,003,796.00	11,532,137.00
2	Legalizimi i ndërtimeve pa leje	350,000.00	400,000.00	450,000.00
3	Leje mjedisore komunale	600,000.00	700,000.00	800,000.00
4	Tatimi në pronën e paluajtshme dhe tokë	14,905,828.00	15,371,529.00	16,269,665.00
5	Menaxhimi i mbeturinave	4,338,000.00	4,338,000.00	4,338,000.00
6	Licenca në biznes	250,000.00	300,000.00	350,000.00
7	Taksa për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike	100,000.00	100,000.00	100,000.00
8	Konfiskimi i veturave - me merimangë	100,000.00	100,000.00	100,000.00
9	Infrastrukturë rrugore	3,000,000.00	3,500,000.00	4,000,000.00
10	Taksa nga kadastri dhe gjeodezia	1,000,000.00	1,200,000.00	1,200,000.00
11	Të hyra nga inspeksioni	150,000.00	150,000.00	150,000.00
12	Taksa për certifikata dhe dokumente zyrtare	250,000.00	250,000.00	250,000.00
13	Taksa për automjete motorike	750,000.00	775,000.00	800,000.00
14	Taksa për shërbime arsimore	800,000.00	800,000.00	800,000.00
15	Biblioteka dhe teatri "Dodona"	20,000.00	20,000.00	20,000.00
16	Taksa për shërbime shëndetësore	400,000.00	400,000.00	400,000.00
17	Të hyrat tjera të papërcaktuara	15,000.00	15,000.00	15,000.00
18	Shitja e pasurisë	15,000.00	15,000.00	15,000.00
19	Shpronësime	1,000,000.00	1,000,000.00	1,000,000.00
	Gjithsej	38,778,968.00	40,438,325.00	42,589,802.00

Parashikimi i të hyrave buxhetore 2024 - 2026

Të hyrat vetjake **38,778,968.00 euro** të planifikuara për vitin 2024, do të arkëtohen kryesisht nga taksa për leje ndërtimi, taksa për infrastrukturë rrugore, tatimi në pronën e paluajtshme, tatimi në tokë, nga legalizimi i ndërtimeve pa leje dhe nga menaxhimi i mbeturinave. Burime sekondare të të hyrave do të jenë gjithashtu edhe të hyrat nga shpronësimet e tokave komunale dhe taksa për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike. Vlerësimet e mbështetjes së pritur të donatorëve dhe agjencive qeveritare ndërkombëtare, përfshirë bashkëfinancimin e mundshëm, janë përfshirë në kuadër të të hyrave nga participimet dhe donacionet.

➤ Vlerësimet e hershme të shpenzimeve të programeve buxhetore

Në vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore, përfshihen kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor, duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik dhe fiskal, dhe duke pasur për bazë buxhetin e miratuar për vitin 2024 dhe shpenzimet gjatë viteve të fundit. Kjo kornizë paraqet parashikimin trevjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale.

Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend të rritjes për çdo vit, si dhe të granteve të Qeverisë, të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas qarkoreve buxhetore dhe limiteve të buxhetit, të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i granteve të MF-së.

Grantet qeveritare dhe të hyrat vetjake komunale 2024 - 2026

Në vazhdim janë paraqitur granti i përgjithshëm, granti specifik për kryeqytetin, granti specifik i Arsimit, granti specifik për Shëndetësi, dhe plani i të hyrave vetanake komunale sipas viteve 2024 – 2026 .

Tabela 1: Vlerësimet e burimeve të financimit për Komunën e Prishtinës (2024-2026)

Burimet e financimit	Buxheti	Buxheti i	Parashikimet e hershme ¹	
	aktual	planifikuar	2025	2026
	2023	2024		
Grandi i përgjithshëm	26,200,156	29,968,230	32,270,558	34,339,876
Grandi specifik për arsim	22,483,776	26,506,354	27,301,544	28,120,590
Grandi specifik për shëndetësi	7,512,586	10,456,520	10,979,346	11,528,802
Grandi specifik për kryeqytetin	15,312,600	17,080,800	18,358,380	19,558,800
Të hyrat vetjake	34,166,863	38,778,968	40,438,325	42,589,314
Gjithsej	105,675,981	122,790,872	129,348,153	136,137,382

Tabela 2: Planifikimi i shpenzimeve për Komunën e Prishtinës (2024-2026)

Kategoritë e shpenzimeve	Buxheti aktual	Buxheti i planifikuar	Parashikimet e hershme	
	2023	2024	2025	2026
Paga dhe mëditje	32,470,000	38,000,000	38,500,000	39,000,000
Mallra dhe shërbime	25,000,000	29,000,000	20,000,000	31,000,000
Shpenzime komunale	2,700,000	3,000,000	3,500,000	4,000,000
Subvencione dhe transfere	5,150,000	7,000,000	8,000,000	9,000,000
Investime kapitale	40,355,981	45,790,872	49,348,153	53,137,382
Gjithsej	105,675,981	122,790,872	129,348,153	136,137,382

ZYRA E KRYETARIT

Kryetar: Përparim Rama

Zyra e Kryetarit

Deklarata e misionit: Realizon mbikëqyrjen e përgjithshme të administrimit financiar të Komunës, kujdeset për zbatimin e vendimeve të marra nga Kuvendi i Komunës, përfaqëson Komunën, zbaton të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës, kujdeset për zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe Statutit të Komunës, përgatit propozime për çështje të caktuara që janë në interes të përgjithshëm të Komunës.

Kryetari i Komunës, në pajtim me dispozitat e LVL-së dhe Statutit të Komunës, është përgjegjës të:

1. përfaqësojë Komunën dhe të veprojë në emër të saj;
2. udhëheqë ekzekutivin e Komunës dhe administratën e saj, dhe të mbikëqyrë administrimin financiar të Komunës;
3. ushtrojë të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij;
4. ekzekutojë aktet e Kuvendit të Komunës;
5. emërojë dhe shkarkojë zëvendësin e tij/saj;
6. emërojë dhe shkarkojë drejtorët, të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
7. organizojë punën dhe të drejttojë politikën e Komunës;
8. propozojë rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës;
9. propozojë zhvillimin komunal, planet rregulluese dhe investuese, të propozojë buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe të ekzekutojë buxhetin e miratuar;
10. raportojë para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomike – financiare të Komunës

- dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, së paku një herë në gjashtë muaj, apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës;
11. kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsiderohet se akti bie në kundërshtim me legjislacionin në zbatimin, apo interesin e komuniteteve;
 12. mbikëqyrë administrimin e përgjithshëm financiar;
 13. delegojë përgjegjësi te anëtarët e Këshillit të Drejtorëve dhe të mbikëqyrë zbatimin e përgjegjësive të deleguara.

Nënkryetarë

Deklarata e misionit: Organizon koordinimin e punës me komitetet e fshatrave dhe bashkësive, mbikëqyrë marrëdhëniet me publikun, koordinon oraret me mediat elektronike dhe të shkruara, zëvendëson kryetarin në rast të mungesës së tij.

Sektori i auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga tre auditorë. Kjo njësi gjatë vitit fiskal, kryen auditime nëpër drejtoritë komunale. NJAB-ja ka për mision të kontrollojnë ecurinë e punëve dhe shërbimeve të cilat ofrohen në organizatën tonë buxhetore. Qëllimi i tyre është që të ngrihet niveli i performancës së Komunës.

Në kuadër të misionit të saj, Njësia e auditimit të brendshëm:

- siguron zbatimin adekuat dhe respektimin e ligjeve, rregulloreve, politikave, udhëzimeve dhe doracakëve;
- siguron përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të planeve për auditim të brendshëm;
- organizon, kryen dhe mbikëqyrë ushtrimin e të gjitha aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe dorëzon rezultatet e auditimit para Komisionit të auditimit;
- përgatit dhe dorëzon raporte tremujore dhe vjetore mbi të gjitha aktivitetet e auditimit të NJAB-së te Komisioni i auditimit;
- kryen auditime të brendshme në pajtim me rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet dhe standardet profesionale të nxjerra nga organet qendrore dhe lokale, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- shqyrton të gjitha të dhënat teknike, ekonomike dhe financiare, si dhe informatat e dokumentit në posedim ose kontroll të subjektit në auditim;
- kopjon të dhënat, informatat apo dokumentet për qëllime të auditimit të brendshëm dhe siguron që kopjet në fjalë të jenë origjinale ose të vërtetuara;

- mund të kërkojë nga cilido zyrtar, punonjës, këshilltar që të ofrojë dëshmi fizike, shënime ose dëshmi gojore, ose informata të tjera mbi çështjet që kanë të bëjnë me auditimin ose mbi aktivitetet që janë në auditim;
- ka qasje pa pengesë në stabilimentet e subjektit në auditim, dhe verifikon dhe vlerëson vlerat materiale dhe monetare të subjektit, në pajtim me rregullat dhe legjislacionin në fuqi;
- propozon masat që duhet të ndërmerren nga subjekti përkatës;
- merr informata të certifikuara nga Thesari, BPK-ja dhe cilado organizatë publike apo private në lidhje me xhirollogarinë aktuale apo të mbyllur;
- për punën e vet i përgjigjet Kryetarit të Komunës;
- kryen edhe punë të parapara sipas ligjit, Statutit të Komunës së Prishtinës dhe rregulloreve në fuqi, si dhe vendimeve dhe urdhëresave të Kryetarit të Komunës.

Sektori i burimeve njerëzore

Sektori i burimeve njerëzore ushtron kompetenca në përputhje me autorizimet, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet ligjore që i përkasin, në funksion të zbatimit të kërkesave ligjore të dispozitave të Ligjit për shërbimin civil, Ligjit të punës dhe akteve të brendshme të Komunës.

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisve që ka, bën:

- vlerësimin dhe miraton kërkesat për plotësimin e vendeve të punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mundësitë buxhetore të Komunës;
- hartimin dhe shpalljen e konkurseve për plotësimin e vendeve të lira, në përputhje me ligjin dhe procedurat në fuqi;
- propozimin e komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për plotësim të vendeve të lira, në përputhje me ligjin dhe procedurat;
- hartimin e vendimeve dhe formën e kontratave për kandidatët e përzgjedhur;
- iniciimin e procedurës disiplinore ndaj nëpunësve civilë, në rastet e shkeljeve të detyrave të punës dhe shkeljeve të tjera të kodit të mirësjelljes, me kërkesë të zyrtarit kompetent;
- zbatimin e pezullimit parandalues, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;
- përkujdesje për të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në kuadër të Komunës së Prishtinës, në pajtim me dispozitat e ligjeve në fuqi;
- krijimin, kultivimin dhe ruan relacionet e bashkëpunimit me zyra dhe asociacione që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat dhe obligimet e nëpunësve civilë dhe publikë;
- hartimin dhe kujdeset për evidencën e punëtorëve -shërbyesve civilë të drejtorive të administratës komunale, në përputhje me rregullat dhe procedurat e legjislacionit në fuqi;
- bashkëpunon me të gjitha drejtoritë komunale;
- kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë-veprimtarisë së Sektorit.

Njësia e personelit udhëhiqet nga udhëheqësi/menaxheri i Personelit, i cili rekrutohet nga Kryetari i Komunës, në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe procedurat për legjislacionin civil; Udhëheqësi/menaxheri i Personelit për punën e tij, i raporton Kryetarit të Komunës.

Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integrim evropian

Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe qytete, ushtron kompetenca në përputhje me autorizimet, përgjegjësitë dhe të drejtat, detyrimet ligjore dhe të kërkesat e Kryetarit të Komunës.

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiqe që ka, ky sektor:

- ofron mbështetje profesionale dhe teknike për Kryetarin e Komunës, në krijimin dhe fuqizimin e marrëdhënieve me vende dhe qytete të vendeve të tjera;
- kujdeset për organizimin dhe përgatitjet teknike të vizitave zyrtare jashtë vendit;
- kujdeset për organizimin dhe përgatitjet teknike të pritjeve zyrtare brenda vendit;
- kujdeset për organizimin dhe përgatitjet teknike të takimeve dhe konferencave rajonale dhe ndërkombëtare, të iniciuara nga Komuna e Prishtinës;
- ofron informata dhe dokumente të nevojshme për aktivitetet ndërkombëtare të Kryetarit të Komunës;
- ruan, mirëmban dhe sistemon dokumentacionin mbi marrëdhëniet ndërkombëtare të Komunës së Prishtinës me vende dhe qytete të vendeve të tjera;
- kujdeset për shkëmbimin e informacioneve, dhuratave dhe letërkëmbimeve të Kryetarit të Komunës me personalitet ndërkombëtare;
- përgatit materiale të nevojshme për nevojat e Komunës, për çështjet që lidhen me integrimet evropiane;
- hulumton programe të ndryshme të asistencës së BE – së, që ofrojnë mbështetje për qeverisje dhe zhvillim lokal;
- kryen edhe punë të tjera, me kërkesë të Kryetarit të Komunës dhe në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë-veprimtarisë së Sektorit.

Sektori për politika publike.

Sektori për politika publike, ushtron kompetenca në përputhje me autorizimet, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet ligjore, si dhe kërkesat e Kryetarit të Komunës.

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiqe që ka:

- ofron mbështetje profesionale dhe teknike për Kryetarin e Komunës në fushën e politikave publike;
- koordinon dhe ofron mbështetje në formulimin e politikave publike lokale;
- ndërmer aktivitete hulumtuese që ofrojnë informacion dhe analiza mbi politikat publike lokale, me kërkesë të Kryetarit të Komunës;
- organizon dhe përgatit tryeza diskutimi mbi politikat publike lokale.

Sektori për komunikim me publikun

Sektori për politika publike, ushtron kompetenca në përputhje me kërkesat e Kryetarit të Komunës.

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka:

- merr pjesë në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës, brenda dhe jashtë Komunës;
- përcjell mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve, të komiteteve dhe të Kuvendit të Komunës;
- koordinon ndërlidhjen me shtypin vendor dhe atë ndërkombëtar, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Kryetarit të Komunës, drejtorëve të drejtorive dhe zyrave të tjera;
- koordinon zhvillimin dhe zbatimin e akteve komunale për komunikim me publikun;
- ofron informata për politikat e zhvillimit të Komunës;
- mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë për komunikim me qytetarë dhe administron Kodin e mirësjelljes së zyrtarëve për komunikim, për të mbajtur standarde të larta etike për zyrtarët për komunikim;
- siguron transparencë dhe qasje publike për punën e drejtorëve të administratës komunale, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe të ndërmarrjeve publike lokale, duke u ofruar informata dhe dokumente qytetarëve dhe medie;
- informon publikun për vendimet që merr Kuvendi i Komunës, me anë të konferencave dhe lëshimit të kumtesave për shtyp;
- mban lidhje me shtypin lokal dhe mediat elektronike për çështjet që u takojnë organeve të Komunës;
- është kompetente për publikimin e gazetës së brendshme “Buletini”, në nivel të Komunës;
- siguron informacione brenda Komunës dhe është në bashkëpunim të përhershëm me drejtorët e drejtorive dhe shërbyesit civilë të punësuar në drejtoritë e administratës;
- shoqëron përfaqësuesit e mediave brenda Komunës dhe regjistron deklaratat e zyrtarëve komunalë dhënë përfaqësuesve të mediave;
- përgatit fletëpalosje, buletin, broshura etj.;
- seleksionon dhe arkivon shkrimet e gazetave që kanë të bëjnë me Komunën;
- kryen edhe punë të parapara me ligj, Statutin e Komunës së Prishtinës dhe me rregulloret tjera.

Sektori për të drejta të njeriut dhe komunitete

Sektori për të drejta të njeriut dhe komunitete, ndërmerr të gjitha masat e nevojshme lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në nivel komunal.

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiqe që ka:

- monitoron përputhshmërinë e respektimit të standardeve për të drejtat e njeriut në fushat: mundësi të barabarta, kundër diskriminimit, barazia gjinore, të drejtat e fëmijëve, personat me aftësi të kufizuar, të drejtat e komuniteteve, përdorimin e gjuhëve dhe kundër trafikimit me qenie njerëzore;
- këshillon për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të nxjerra nga Kuvendi i Komunës, në përputhje me standardet për të drejtat e njeriut dhe legjislacionit vendor;
- monitoron aktivitetet e Komunës dhe, në të njëjtën kohë, këshillon Kryetarin e Komunës lidhur me çështjet e të drejtave të njeriut;
- harton dhe zhvillon planet e veprimt, identifikon nevojat për ngritjen e kapaciteteve dhe planifikon buxhetin për zbatimin e aktiviteteve të NJDNJK-së;
- raporton në baza mujore, tremujore dhe gjashtëmujore, sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës;
- zbaton ligjet, planet dhe strategjitë e miratuara nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës;
- bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me strukturat e nivelit komunal dhe OJQ – të, në sferën e mbrojtjes dhe promovimin e të drejtave të njeriut;
- bashkëpunon me institucionet dhe agjencitë qendrore, me qëllim të realizimit të përgjegjësiqe, duke përfshirë edhe institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë;
- merr pjesë në mbledhjet e komitetet ekzistuese (Komiteti për Komunitete, Komiteti për Ndërmjetësim, apo Komiteti për Financa) dhe në forumet tjera, ku çështjet lidhur me të drejta e njeriut dhe komunitetet janë pjesë e rendit të ditës.

Sektori ligjor

Sektori ligjor i Komunës, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiqe që ka:

- ofron ndihmë juridike, këshillime dhe bën ekspertizë për nevojat e Kabinetit të Kryetarit, drejtorive, sektorëve/njësiqe dhe të institucioneve të arsimit, të shëndetësisë dhe të ndërmarrjeve komunale;
- shqyrton të gjitha projekt rregulloret që propozuesit ia dërgojnë për miratim Këshillit të Drejtorëve, komiteteve kompetente dhe Kuvendit të Komunës, duke garantuar pajtueshmëri me ligjet ekzistuese në fuqi dhe Statutin e Komunës;
- shqyrton propozimet e vendimeve dhe akteve të tjera që i propozohen Kuvendit për miratim;
- harton vendime dhe urdhëresa administrative, të kërkuara nga Kryetari i Komunës;
- ruan dokumentacionin e Zyrës ligjore dhe bën shtypjen e të gjitha materialeve dhe akteve të tjera nga përgjegjësiqa e kësaj zyre;
- bashkëpunon me bashkëpunëtorët profesionalë dhe iu ndihmon atyre në aspektin ligjor në përgatitjen e vendimeve dhe akteve tjera juridike, si dhe të materialeve tjera të ndryshme;

- përfaqëson dhe mbron interesin e Komunës dhe të institucioneve që financohen nga Komuna në procedurat gjyqësore civile, penale, përmbarese dhe administrative në gjykatat e vendit në të gjitha nivelet;
- ndërmer të gjitha veprimet procedurale për mbrojtjen e interesit pasuror dhe juridik të Komunës, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara me ligj;
- kryen edhe punë të tjera të parapara me ligj, me Statutin e Komunës së Prishtinës dhe me rregullore të tjera.

Sektori i prokurimit

Sektori i prokurimit, aktivitetin, kompetencat dhe përgjegjësitë i ushtron në kuadër të Ligjit (në fuqi) për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, akteve dhe autorizimeve të autoritetit kontraktues - Kryetarit të Komunës, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat në fuqi; Sektori i prokurimit dhe zyrtari i prokurimit, në kuadër të obligimeve, autorizimeve dhe përgjegjësiave ligjore dhe duke hyrë në raporte kontraktuale me fondet publike dhe burimet publike, obligohet që ato t'i përdorin në mënyrën më ekonomike, duke marrë parasysh qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Sektori i prokurimit, aktivitetin e saj në fushën e prokurimeve e bazon në parimet e ekonomizimit dhe të transparencës, si dhe në atë të barazisë në trajtim të mos diskriminimit dhe efikasitetit të ushtrimit të aktiviteteve të prokurimeve.

Komuna e Prishtinës (si autoritet kontraktues) obligohet, me këtë edhe departamenti/Sektori i prokurimit, që në fushën e menaxhimit, shfrytëzimit, organizimit dhe deponimit në burimet publike dhe fonde publike në fushën kontraktuale të punëve publike në interes për Komunën e Prishtinës, siguron dhe është përgjegjës që:

- të gjithë operatorët ekonomikë t'i trajtojë në mënyrë të barabartë dhe pa kurrfarë diskriminimi (si dhe pa kurrfarë favorizimi) dhe të veprojnë me transparencë të plotë, në të gjitha fazat e prokurimit. Në këtë cilësi, zyrtari i prokurimeve obligohet dhe është përgjegjës që të sigurojë pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë të interesuar në procedurat e tenderimit;
- të bëjë publikimin e të gjitha informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit, në përputhje me ligjin;
- të sigurojë dhe eliminojë çdo tendencë të dhënies së kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë apo favorizojnë një apo më shumë operatorë ekonomikë;
- të sigurojë që të gjitha specifikacionet teknike të precizohen paraprakisht dhe me saktësinë më të madhe të mundshme, duke përfshirë të gjitha kërkesat dhe kriteret, si dhe metodat e përzgjedhjes së dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës;
- konkursit të projektimit në ftesën për tender, ose pjesëmarrje dhe në dosjen e tenderit, dhe që asnjë kërkesë, kriter apo specifikim që nuk është saktësuar, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes dhe të dhënies së kontratës me fondet publike në Komunën e Prishtinës;

- të mbajë evidencën për tërë procesin e prokurimeve, prej fillimit të aktivitetit të prokurimit e deri në dhënien e kontratës;
- në përputhje me ligjet dhe procedurat në fuqi, palës së interesuar (operatorit ekonomik) t'i ofrojë qasje të drejtpërdrejtë në të gjitha të dhënat lidhur me një aktivitet të prokurimit, përveç informacioneve sekrete afariste;
- kontrata publike t'i jepet operatorit ekonomik që i ka plotësuar të gjitha kriteret më parë të publikuara në njoftimin e kontratës;
- të ruajë deklaratat e nevojave të Kryetarit të Komunës dhe vendosmërisë për disponueshmërinë e fondeve të ZKF-së, Sektori i prokurimit, bën hetimet adekuate të tregut për mallrat, shërbimet ose punët që janë objekt i kontratave (objekt prokurimi);
- të zbatojë rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve kohore, kur rrethanat kërkojnë zbatimin e një aktiviteti të prokurimit në raste urgjente për Komunën, në përputhje me legjislacionin dhe procedurat në fuqi;
- të kujdeset dhe ta njoftojë Kryetarin e Komunës për formimin e komisionit për hapjen publike të tenderëve dhe të komisionit për vlershmin e tyre;
- të kujdeset dhe të zbatojë ndalesat sipas dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me operatorët ekonomikë, të cilët konkurrojnë për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale me Komunën e Prishtinës (duke u kërkuar dëshmi valide);
- të kujdeset që me raportet kontraktuale të Komunës, të shqyrtojnë dhe vlerësojnë besueshmërinë e operatorëve ekonomikë, rreth gjendjes së tyre ekonomike dhe financiare, si dhe aftësive të tyre teknike dhe profesionale;
- t'i propozojë Kryetarit të Komunës (autoritetit kontraktues) themelimin e jurisë vlerësuese dhe kriteret e përgjegjësisë së tyre sipas ligjit në konkurset e projekteve në interes të Komunës;
- është përgjegjës dhe mban të gjitha format e përgjegjësisë ligjore, sipas Kodit penal të Kosovës, dhe i nënshtrohet dispozitave ndëshkuese të këtij kodi, për ndikim të paligjshëm në prokurim dhe mashtrim në prokurim;
- Zyrtari i prokurimit të autoritetit kontraktues, është personi i vetëm i autorizuar për lidhjen dhe nënshkrimin e një kontrate publike në emër të autoritetit kontraktues (Komunës), pas plotësimit të të gjitha kushteve të parapara ligjore;
- Zyrtari i prokurimit është shërbyes civil dhe përgjigjet sipas dispozitave të Ligjit për shërbimin civil të Kosovës dhe largohet sipas procedurave të parapara me këtë ligj.
- Sektori i prokurimit ushtron edhe funksione të tjera administrative në bazë të ligjeve në fuqi dhe akteve tjera nënligjore, si dhe në bazë të vendimeve apo urdhëresave të Kryetarit të Komunës, të cilit i përgjigjen me raporte periodike 3-mujore dhe vjetore.
- Kryen edhe punë të parapara me ligj, Statutin e Komunës së Prishtinës dhe me rregulloret në fuqi.

ZYRA E KUVENDIT TË KOMUNËS

Kryesuesi i Kuvendit:

Deklarata e misionit: Duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale, ligjet në fuqi, Statutin e Komunës, rregulloret, udhëzimet e Kuvendit të Komunës, Zyra e Kuvendit duhet:

- të ofrojë zbatimin e tyre në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase;
- të organizojë punën e Kuvendit të Komunës, duke planifikuar buxhetin dhe kujdeset përmenaxhimin optimal të tij;
- kryen punët administrative dhe profesionale, duke përfshirë këtu edhe punët teknike për organizimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, komiteteve dhe komisioneve punuese të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë këtu edhe përpilimin e projekt akteve që i procedohen për miratim këtyre organeve;
- të kryejë punë të tjera për të gjitha organet e administratës, duke përfshirë këtu pranimin e shkresave të ndryshme, dorëzimin dhe ekspeditivin e shkresave zyrtare, vërtetimin e dokumenteve dhe nënshkrimin, punët e arkivit dhe ekspeditivit.

Deklarata e vizionit: Duke menaxhuar me buxhetin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, konform vendimit të Kuvendit të Komunës për miratimin e buxhetit dhe duke u bazuar në dispozitat e ligjeve në fuqi, duke përfshirë këtu edhe vendimet e Kuvendit të Komunës, angazhohet që qytetarëve të komunës t'u ofrohen shërbime sa më të mira dhe më të shpejta, konform detyrave dhe përgjegjësisve të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë këtu lëshimin e dëshmimeve për anëtarët e Kuvendit të Komunës, përpilimin e vendimeve të Kuvendit, ekspeditivin e akteve zyrtare e materialeve për nevojat e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, bën përpunimin administrativ-teknik të akteve dhe lëndëve, arkivimin e lëndëve etj..

Deklarata e qëllimit: Qëllimi i punës së kryesuesit të Kuvendit është që, duke e njohur nevojën për të sjellë vendimmarrjen më afër qytetarëve, të promovojë qeverisje të mirë dhe kushte të jetesës për të gjithë qytetarët e komunës, duke avancuar një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale dhe të përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve publike në Komunën e Prishtinës.

Me një menaxhim sa më të mirë të punës së Kuvendit, të organizojë sa më mirë punën e personelit të shërbimit profesional të Kuvendit, me menaxhim optimal të buxhetit të saj, të krijojë kushte për punë efikase dhe transparente të Kuvendit të Komunës dhe të trupave të tij, në mënyrë që qytetarëve, në bazë të kompetencave tona, t'u ofrohen shërbime në afatet e parapara me ligj, me pretendim që këto afate të jenë sa më të shkurtra.

DREJTORITË E KOMUNËS SË PRISHTINËS

Drejtoria e Administratës

Deklarata e misionit:

Zbatimi i dispozitave ligjore, rregulloreve në organet e administratës komunale. Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiqe që ka kjo drejtori:

- organizon metodën e punës në organet komunale të administratës;
- lëshon certifikata dhe akte të tjera nga evidenca zyrtare që mban;
- planifikon buxhetin e Drejtorisë dhe kujdeset për menaxhimin optimal të tij;
- kryen punët administrative për nevojat e këtyre organeve, që kanë të bëjnë me: përgatitjen profesionale, teknike dhe organizimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Bordit të Drejtorëve dhe trupave punues të emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe Bordi i Drejtorëve, si dhe përpunimin profesional të akteve të miratuara nga këto mbledhje.

Punët e përbashkëta për të gjitha organet e administratës: Punët e pranimit të shkresave të ndryshme, dorëzimin dhe ekspeditivin e shkresave zyrtare, vërtetimin e dokumenteve dhe nënshkrimin e tyre, punët e arkivit dhe ekspeditimit, zbatimin e procedurave ligjore nga lëmi i marrëdhënies së punës, mirëmbajtjen dhe pastrimin e objekteve, prokurimin dhe furnizimin me mallra dhe shërbime, nxehjen qendrore, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e automjeteve të Komunës dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kompjuterëve.

Deklarata e vizionit:

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiqe që ka:

- lëshon deklarata për gjendjet e përbashkëta familjare;
- përgatit vërtetimin e nënshkrimeve personale;
- lëshon vërtetime për varshmërinë materiale në diasporë etj.;
- lëshon certifikata në bazë të dy dëshmitarëve dhe provave të tjera;
- protokollon, pranon shkresat nga palët, sistemon, evidenton dhe dërgon aktet në përpunim të mëtejme sipas drejtorive dhe sektorëve të veçantë, dhe bën ekspeditivin e akteve zyrtare e materiale për nevojat e Kuvendit të Komunës;
- bën përpunimin administrativ-teknik të akteve dhe i lëndëve, pranimin, hapjen, klasifikimin e postës, dërgimin e postës, arkivimin e lëndëve, ruajtjen e lëndëve arkivore të përfunduara;
- ndarjen e materialit të pavlefshëm të regjistraturës dhe dorëzimin e lëndës arkivore, arkivit kompetent, shpërndarjen e thirrjeve përmes centralit telefonik etj..

Deklarata e qëllimit:

Drejtoria e Administratës dhe Personelit:

- bën regjistrimin e të porsalindurve në LAL;
- bën regjistrimin e të vdekurve në LAV;
- bën celebrimin e martesave dhe regjistrimin në LAM;
- mban librat amzë të të lindurve;
- mban librat amzë të të martuarve;
- mban librat amzë të të vdekurve;
- bënë ndryshime dhe përmirësime të emrave personalë, sipas kërkesës së palës;
- lëshon certifikata për faktet që mbajnë evidencë sipas detyrës zyrtare;
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore;
- bënë përgatitjen dhe organizimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe përpunimin profesional të akteve të miratuara në seanca;
- ruan dokumentacionin dhe burimet e dokumenteve,
- mban evidencën e mbledhjeve të mbajtura të Kuvendit dhe komiteteve, procesverbaleve dhe stenogramet nga seancat e Kuvendit;
- bën publikimin e vendimeve dhe akteve të tjera të miratuara nga këto organe në Gazetën zyrtare dhe mjetet tjera të informimit;
- kryen punë profesionale për anëtarët e Kuvendit, organet e tij, lidhur me mirëvajtjen e punës, sidomos rreth peticioneve, ankesave, parashtresave, të cilat në forma të ndryshme i drejtohen këtyre organeve dhe komiteteve të zgjedhura nga Kuvendi i Komunës;
- përgatit procedurat e nevojshme lidhur me tubimet publike të Kuvendit të Komunës me qytetarë, bashkësitë lokale dhe organizmat tjerë relevantë;
- jep instruksione profesionale lidhur me materialet që i shqyrton Kuvendi, Bordi i Drejtorëve dhe Komitetet e Kuvendit;
- kryen detyra tjera sipas udhëzimeve dhe urdhëresave të Kryetarit të Komunës;
- zbaton Ligjin mbi shërbimin civil dhe zbaton urdhëresat administrative lidhur me zbatimin e procedurave të shpalljes së konkurseve, rekrutimit, selektimit, mirëmbajtjes së dosjeve të punëtorëve të shërbimit civil dhe të procedurave tjera që dalin nga ligji dhe udhëzimet administrative që rregullojnë këtë fushë;
- është përgjegjëse për zbatimin e procedurës së tenderimit, në bazë të rregullativës ligjore në fuqi;
- merret me administrimin e rrjetit të kompjuterëve, përpunimin e ueb-faqes së Komunës dhe përcjelljen e trendëve bashkëkohorë nga fusha e teknologjisë informative.

	Administrata	2024	2025	2026
1	Ndërtimi i objektit të zjarrfikëseve	200,000	-	-
2	Ndërtimi i objektit të Arkivit të Komunës, me infrastrukturë përcjellëse	400,000	-	-
3	Sistemet inteligjente të menaxhimit të ndërtesave dhe zyrave në komunën e Prishtinës	200,000	200,000	100,000
4	Rikonstruktimi dhe renovimi i përgjithshëm i objekteve të Komunës	250,000	300,000	350,000
5	Klimatizimi dhe ventilimi i ndërtesave të Komunës, dhe njërive vartëse	200,000	250,000	-
6	Projektet sipas kërkesës së banorëve nëpër lagjet e ndryshme të kryeqytetit	500,000	-	-

Drejtoria e Financave

Deklarata e misionit: Misioni i kësaj drejtorie është menaxhimi i buxhetit dhe financave të Komunës, që d.m.th.:

- siguron drejtorinë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhimin e shpenzimeve dhe zhvillimin ekonomik;
- informon liderët komunalë me aktualitetet e ndërlidhura me buxhetin e Komunës;
- përgatit rregulloret për KPF;
- bën menaxhimin e financave komunale;
- bën përgatitjen e prezantimit të buxhetit;
- koordinon punët dhe aktivitetet e drejtorisë;
- këshillon zyrtarët komunalë për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin dhe financat.

Deklarata e vizionit: Në bazë të kompetencave dhe përgjegjësisë që ka kjo drejtori:

- menaxhon me buxhetin komunal;
- përgatit buxhetin komunal për të gjitha programet buxhetore brenda afateve kohore të përcaktuara nga MEF-i, duke u bazuar në qarkoret buxhetore dhe dokumentacionin

- plotësues;
- bën rishikimin buxhetor, analizat, raportet periodike financiare etj.;
- perfeksionimi i mbajtjes së evidencës së kontabilitetit dhe mundësia për ngritjen në nivel më të lartë.

Sektori i tatimit në pronë, menaxhon ekskluzivisht vetëm tatimin në pronë:

- përgatitjen e faturave;
- shpërndarjen e faturave tatimore;
- planifikimin e arkëtimit të tatimit në pronë dhe raportimin e rregullt pranë MFE-së, Zyres rajonale dhe Drejtorisë për realizimin e të hyrave nga tatimi në pronë, në baza mujore, si dhe përmbushja e planit vjetor;
- pasurimin dhe inkorporimin e elementeve shtesë për skemën e tatimit dhe freskimin vjetor të të dhënave me gjendjen në terren dhe aprovimin e ndryshimeve – plotësimeve të rregulloreve komunale të tatimit në pronë dhe tarifave, ngarkesave dhe gjobave komunale për këtë kategori të të hyrave.

Deklarata e qëllimit: Synimi i kësaj drejtorie është që:

- të ngrihet niveli i menaxhimit të financave komunale për të gjithë administratën lokale;
- të mbajë kontabilitetin dhe financat;
- të përpilojë raportet mujore dhe vjetore mbi financat komunale;
- të mbajë evidencën e kontabilitetit për të hyrat vetjake komunale për çdo program buxhetor, si dhe barazimet periodike (mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore me MF-në, Departamentin e Thesarit). Zyra menaxhon të gjitha shpenzimet e Komunës, sipas udhëzimeve nga MF-ja. Për secilën program buxhetor, përmes sistemit të kontabilitetit të Free-Balanced, përmes të cilit bëhet realizimi i shpenzimeve buxhetore (alokimi, zotimi dhe realizimi i pagesave), duke u bazuar në rrjedhjen e parasë së gatshme Cash– planit.

Sektorit i tatimit në pronë

Deklarata e misionit: Tatimi në pronë është tatim vjetor i Komunës. Të hyrat nga tatimi në pronë përdoren për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunën tuaj. Duke paguar tatimin në pronë, ju jeni duke u bërë pjesë e përpjekjeve për të zhvilluar komunën tuaj. Tatimi në Pronë është tatim vjetor të cilin e vendos Komuna. Tatimi caktohet për të gjitha pronat e paluajtshme që janë nën apo mbi nivelin e tokës. Kjo përfshin njësitë brenda ndërtesave, si apartamente dhe hapësira për përdorim komercial. Disa institute dhe organizata përjashtohen nga ngarkesa me tatim në pronë. Të hyrat e grumbulluara nga tatimi në pronë, së bashku me të hyrat tjera, përdoren për zhvillimin e infrastrukturës në komunën tuaj, si: rrugë, shkolla, ambulanca dhe investime të ngjashme, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës në komunën tuaj. Nga viti 2020, komuna e Prishtinës ka filluar me arkëtimin e tatimit në tokë. Kjo është potencuar edhe me Qarkoret buxhetore sipas viteve ku si plan i të hyrave është inkorporuar edhe tatimi në tokë.

Drejtoria e Inspeksionit

Deklarata e misionit: Që të zhvillojë dhe të sigurojë me efektivitet dhe efikasitet:

- kushtet higjiene-sanitare dhe teknike në ambientet ku jetojnë qytetarët e Prishtinës, ku punojnë, edukohen, shërohen, argëtohen etj.;
- normat dhe standardet e operatorëve që kryejnë veprimtari ligjore nga kompetenca e kësaj drejtorie;
- implementimin e masave dhe programeve preventive, përmes zhvillimit dhe forcimit të inspektimeve kompetente ligjore.

Deklarata e vizionit: Vizioni i DI-së është mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e shëndetit publik, mbikëqyrja dhe aplikimi i ligjeve për planin zhvillimor, rregullues dhe urbanistik, përmes inspektimeve, vendimeve, pëlqimeve, evidentimeve dhe ndërmarrjes së masave ligjore ndaj subjekteve – operatorëve që kryejnë veprimtari joligjore nga kompetenca e kësaj drejtorie, duke siguruar kushte dhe ambient të shëndoshë për qytetarët e Prishtinës.

Deklarata e qëllimit: Mbikëqyrja dhe aplikimi i ligjeve dhe akteve të tjera ligjore në fushën e ndërtimit, tregut sanitar, veterinarisë, bujqësisë, mbrojtjes së ambientit, trafikut urban - komunikacionit, hidroekonomisë, rrugëve etj. Promovimi i kushteve higjiene - sanitare dhe teknike në institucionet publike dhe private. Zhvillimi i resurseve humane dhe forcimi i llogaridhënies.

Drejtoria e Urbanizmit

Deklarata e misionit: Misioni parësor i Drejtorisë së Urbanizmit është krijimi i një ambienti të shëndoshë për banim, punë, rekreacion, duke respektuar rregullativën ekzistuese ligjore. Drejtoria është bartëse kryesore e hartimit të detyrave projektuese për planet zhvillimore komunale –urbane dhe planeve rregulluese urbane, njëherësh bën implementimin e tyre, lëshon lejet e ndërtimit, kujdeset për dokumentacionin investivo – teknik dhe përputhshmërinë e tij me kushtet e dhëna urbano - teknike. Lejon shfrytëzimin e hapësirave publike, mbulon sferën e banimit, zbaton vendimet e gjykatës për ndarje, bartje të pronësisë dhe bashkëpunon ngushtë me nivelin qendror – Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Deklarata e vizionit: Kujdeset për zbatimin e planeve zhvillimore dhe planeve rregulluese urbane, dhënien e lejeve të ndërtimit konform rregullativave ekzistuese, kontrollimin e dokumentacioneve investivo - teknike, shfrytëzimin e sipërfaqeve publike në përputhje me rregulloret dhe realizimin e mjeteve financiare, duke paraqitur shtyllën kryesore të të hyrave vetanake në buxhetin komunal.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Oëndrueshëm

Deklarata e misionit: Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave që ka, kjo drejtori:

- është bartëse e procedurave të hartimit të Planit zhvillimor komunal – urban, Hartës zonale dhe planeve rregulluese urbane;
- merret me monitorimin dhe evoluimin e këtyre planeve;
- harton propozimet dhe kushtet e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim me interes të përgjithshëm shoqëror;
- jep hapësirat publike në shfrytëzim të përkohshëm;
- kujdeset për zbatimin e ligjeve të fushës së planifikimit hapësinor, si Ligjit për planifikim hapësinor të Kosovës (LPH), respektimit të rregullativës ekzistuese ligjore.

Deklarata e vizionit: Drejtoria siguron drejtime dhe koordinon me zyrat tjera komunale dhe me bizneset private. Administrata bënë planifikimin dhe mbikëqyr punën e bërë në bazë të Planit të zhvillimit ekonomik lokal. Administrata jep këshillime për komunitetin e biznesit dhe kryen shërbime të tjera.

Drejtoria e Kadastrit

Deklarata e vizionit: Drejtoria është përgjegjëse për:

- zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale;
- rrjetin referues homogjen;
- rikonstruktimin e informatave kadastrale në formë digjitale;
- modelin e sistemit informativ për tokën dhe pronën;
- ofrimin e shërbimeve profesionale dhe shërbimeve të tjera për subjekte të interesuara, përmirëson transferimin e tokës, menaxhimin e tokës shtetërore dhe efikasitetin në tatimin e tokave;
- planifikon rrjetin me pika të reja kontrolluese dhe themelon pika të reja kontrolluese; digjitalizon pikat poligonale dhe trigonometrike, vektorizimin e planeve të skanuara (ngastrave dhe zonave kadastrale);
- azhurnon pjesën grafike, në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe i transformon me parametrat e dhëna për transformim;
- ofrimin e shërbimeve rreth mirëmbajtjes dhe klasifikimit të kulturave të tokës.

Drejtoria e Shëndetësisë

Drejtoria e Shëndetësisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe mbështetur në udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës, në kuadër të fushë-veprimtarisë së saj:

- ushtron dhe është përgjegjëse për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve specifike, për të arritur objektivat e shërbimit të shëndetësisë parësore në komunën e Prishtinës; vlerëson nevojat lokale shëndetësore, harton buxhetin, në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- zbaton kujdesin parësor shëndetësor, duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare;
- zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore, sipas akteve ligjore të miratuara nga MSH-ja;
- vendos dhe mbledh bashkëpagesat brenda kornizës së përcaktuar nga ministritë e linjës;
- përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor;
- ushtron kompetenca dhe përgjegjësi të tjera që dalin nga ligjet e veçanta, Statuti i Komunës, aktet nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;
- mbikëqyrë situatën epidemiologjike në nivel të komunës;
- mbledh dhe analizon informatat në fushën shëndetësore në nivel lokal;
 - koordinon dhe mbikëqyr punën e QKMF-së, QMF-së dhe ambulancave shëndetësore; organizon fushata sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe joqeveritare dhe harton marrëveshje bashkëpunimi në fushën shëndetësore;
- raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe të arriturave komunale në këtë fushë;
- harton propozimet për lirimet nga shërbimet ndaj qytetarëve, nëse skemat janë bazuar mbi kriteret e objektivit të hapur ndaj publikut dhe në pajtueshmëri me ligjin në fuqi;
- ndërmerr veprime për të siguruar fonde të mjaftueshme për ngritjen e vazhdueshme profesionale të profesionistëve shëndetësorë nëpërmjet trajnimeve specifike, në harmoni me aktet ligjore në fuqi;
- zbaton kujdesin parësor shëndetësor në sektorin publik, nëpërmjet shërbimeve të Mjekësisë Familjare, dhe përcjelljen e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e komunës;
- harton strategjitë për kujdesin parësor shëndetësor, bazuar në nevojat e identifikuara në nivel lokal, duke u dhënë prioritet masave parandaluese, dhe në respektim të gjendjes shëndetësore, moshës, gjinisë dhe pozitës ekonomiko - sociale të qytetarëve dhe kushteve dhe mundësive në ofrimin e kujdesit shëndetësor, kushteve teknologjike - mjekësore, distancës dhe konfiguracionit gjeografik, si dhe strukturës dhe përbërjes së institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor.

	Shëndetësia	2024	2025	2026
1	Renovimi i infrastrukturës së objekteve të shëndetësisë primare	400,000	400,000	200,000
2	Furnizim me inventar për nevojat e objekteve të shëndetësisë primare	200,000	250,000	300,000
3	Furnizim me pajisje mjekësore për nevojat e shëndetësisë primare	300,000	300,000	300,000
4	Ndërtimi i Spitalit të Prishtinës	5,000,000	5,000,000	5,000,000
5	Digjitalizimi i shërbimeve shëndetësore	10,000	-	-
6	Furnizimi me auto-vetura për nevojat e shëndetësisë primare	150,000	150,000	150,000

Sqarim : Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe donatorët do të behet projekti "Ndërtimi i Spitalit të Prishtinës".

Drejtoria e Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Mirëqenies Sociale, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, dhe mbështetur në udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës, në kuadër të fushë-veprimtarisë së saj:

- ushtron dhe është përgjegjëse për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve specifike për të arritur objektivat e shërbimeve sociale të komunës së Prishtinës;
- vlerëson nevojat lokale për shërbime sociale;
- harton buxhetin në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore, sipas akteve ligjore të miratuara nga niveli qendror;
- vendos dhe mbledh bashkë pagesat brenda kornizës së përcaktuar nga ministritë e linjës;
- përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e shërbimeve sociale;
- ofron shërbime sociale dhe përkujdesje për rastet sociale të popullatës brenda territorit të komunës;
- kujdeset për të drejtën për të pasur, zhvilluar dhe përdorur pronën, me qëllim të sigurimit të strehimit social të personave brenda territorit të komunës;
- bashkëpunon me ministritë e linjës përkatëse për vendosjen dhe zbatimin e politikave sociale, për kategoritë e fëmijëve të rrezikuar dhe të gjitha grupet tjera vulnerable në nivelin lokal;
- përmes QPS-së, mbledh dhe analizon informatat në fushën sociale në nivel lokal;

- organizon fushata sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare dhe harton marrëveshje bashkëpunimi në fushën sociale;
- koordinon dhe mbikëqyrë punën e Qendrës për Punë Sociale;
- raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe të arriturave komunale në këtë fushë;
- propozon nivelin e qirasë dhe vendosjes së nivelit të lirimt nga pagesa e qirasë për objektet në pronësi;
- harton propozimet për lirimet nga shërbimet ndaj qytetarëve, nëse skemat janë bazuar mbi kriteret e objektivit të hapur ndaj publikut dhe në pajtueshmëri me ligjin në fuqi;
- përgatit planet vjetore për zhvillimin dhe përparimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe mbajtjen e shënimeve statistikore;
- përkujdesjet për sigurimin e strehimit për të pastrehët;
- ndërmer veprime për të siguruar fonde të mjaftueshme për ngritjen e vazhdueshme profesionale të profesionistëve socialë;
- nëpërmjet trajnimeve specifike, në harmoni me aktet ligjore në fuqi, bashkëpunon me ministrinë e linjës në sigurimin, distribuimin dhe ruajtjen e statistikave, informatave dhe konfidencialitetit të familjeve që marrin shërbime socio – familjare;
- sipas legjislacionit në fuqi, siguron fonde optimale për trajnimin e vazhdueshëm të profesionistëve socialë, me qëllim të ngritjes së shërbimeve socio – familjare;
- kryen edhe punë të tjera, në përputhje me ligjet e aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë.

	Mirëqenia Sociale	2024	2025	2026
1	Ndërtimi i shtëpisë për mbrojtje të fëmijëve (të cenueshëm)	180,000	-	-
2	Ndërtimi i Qendrës së re multifunksionale për Punë Sociale	500,000	500,000	-
3	Inventarizimi i Qendrës për Punë Sociale aktuale	100,000	20,000	20,000

Drejtoria e Arsimit

Deklaratë e misionit: Edukimi dhe arsimimi i gjeneratave të reja, që nga niveli parashkollor deri tek shkollimi i mesëm i lartë, duke përfshirë të gjithë, pa dallim etnie, race dhe përkatësie fetare. Zbatimi i ligjeve dhe udhëzimeve administrative të MASHT-së dhe i ligjeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me arsimin, siç janë:

- respektimi dhe zbatimi i vendimeve që dalin nga Bordi ekzekutiv dhe Kuvendi i Komunës;
- zbatimi dhe qasja e drejtë e reformave shkollore, me qëllim të arritshmërisë në shkallën më të lartë, bazuar në standardet evropiane dhe botërore;
- zbatimi dhe qasja e drejtë në vlerësimin e njohurive të nxënësve;
- nxitja e bashkëpunimit me të gjitha shoqatat dhe organizatat që kanë të bëjnë me

- lëmin e arsimit dhe edukimit;
 - bashkëpunimi me DKA-të në nivel vendi;
 - bashkëpunimi dhe përvetësimi i përvojave në fushën e arsimit, jo vetëm në nivel vendi, por edhe më gjerë, veçmas me Republikën e Shqipërisë;
 - nxitja e bashkëpunimit ndërmjet arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve, bashkëpunimi me Zyrën e inspeksionit në nivel rajonal;
 - aftësimi profesional i personelit arsimor;
 - krijimi i kushteve për mbarëvajtjen e mësimi;
 - krijimi i kushteve për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, që kanë të bëjnë me formimin e personalitetit të të gjithë nxënësve;
 - përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës shkollore;
 - përgatitja e objekteve shkollor për fillimin me kohë të vitit shkollor, kalendarit të punës, planprogrameve mësimore dhe dokumentacionit pedagogjik;
 - mbikëqyrja e përgjithshme e punës edukativo-arsimorë;
- Në kuadër të kësaj, DKA në Prishtinë ka në menaxhimin e saj: çerdhe fëmijësh, shkollë artistike, shkolla fillore dhe shkolla të mesme të larta.

	Arsimi	2024	2025	2026
1	Ndërtimi i shkollës në lagjen "Kalabria"	1,100,000	-	-
2	Ndërtimi i shkollës "7 Shtatori"	1,000,000	200,000	-
3	Ndërtimi i Liceut Artistik	1,000,000	1,000,000	200,000
4	Ndërtim i çerdhes "Lulevera"	800,000	100,000	-
5	Ndërtimi i çerdhes "Xixëllonjat"	50,000	-	-
6	Ndërtimi i aneksit të çerdhes "Ardhmëria"	100,000	-	-
7	Renovime dhe mirëmbajtja e shkollave	1,600,000	1,500,000	2,000,000
8	Rregullimi i oborreve dhe terreneve sportive	180,000	150,000	200,000
9	Furnizimi me inventar për shkolla	300,000	200,000	350,000
10	Furnizim me libra për bibliotekat shkollore ne IEAA	55,000	50,000	80,000
11	Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative për IEAA	120,000	150,000	200,000
12	Pajisja e shkollave me rekuizita sportive dhe pajisje tjera sportive	90,000	100,000	150,000
13	Furnizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e elektrike, gjeneratorëve dhe klimave	100,000	1,200,000	150,000

14	Instalimet dhe renovimet e ngrohjes qendrore në IEAA	90,000	90,000	90,000
15	Pagesa për 3 shkollat e reja (PPP) me IFC	2,000,000	2,000,000	2,000,000
16	Pagesa për 5 shkollat e reja (PPP) me IFC	-	3,000,000	3,000,000
17	Bashkëfinancimi I projekteve (BE, KFW, EBRD etj.)	250,000	250,000	250,000
18	Ndërtim i institucionit parashkollor	500,000	550,000	400,000

Sqarim : DKA në bashkëpunim me Ministrin e Arsimit, do të bëjnë "Ndërtimin e Institucioneve Parashkollore"

Drejtoria e Kulturës

Deklarata e misionit: Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të Drejtorisë janë:

- avancimi i përgjithshëm i vlerave kulturore kombëtare dhe sportive;
- shënimi i përvjetorëve të personaliteteve të kulturës dhe historisë kombëtare, të të gjitha kohërave;
- formimi i shoqërive kulturo-artistike, grupeve dhe ekipeve sportive;
- përkrahja e talenteve të reja, në veçanti krijimi i kushteve për zhvillimin e veprimtarive kulturo-artistike dhe sportive;
- prezantimi i denjë i Komunës në nivel vendi dhe më gjerë;
- kujdesi dhe mirëmbajtja e institucioneve të kulturës, rinisë dhe sportit dhe ndërtimi i objekteve të reja;
- nxitja e bashkëpunimit me shoqëritë kulturo-artistike, me grupet rinore dhe ekipet sportive në nivel vendi dhe më gjerë;
- ngjitja e vetëdijes njerëzore në aspektin e dashurisë dhe humanizmit;
- nxitja dhe përkrahja e krijuesve të fjalës artistike;
- botimi i veprave me vlera kulturore e historike kombëtare;
- shtrirja e aktivitetit të sektorit të sportit edhe në shkollat e komunës, me qëllim të zbulimit e të ndihmës së talenteve të reja në fushën e kulturës e të sportit, organizimi i garave në nivel komune, rajoni, vendi e më gjerë.

	Kultura	2024	2025	2026
1	Renovimi dhe rigjenerimi i pikës ikonike të kryeqytetit "Kurrizi"	500,000	500,000	500,000
2	Ndërtimi i bibliotekës dhe qendrës kulturore në lagjen "Kodra e Trimave"	200,000	-	-
3	Ndërtimi i ATC	500,000	700,000	1,000,000

4	Ndërtimi i Sallës Koncertale	2,000,000	2,000,000	1,000,000
5	Revidimi i projektit "Konservimi dhe adaptimi i "shtëpisë shkollë" në Muzeun e Shtëpive Shkolla, lagja e Herticëve -Prishtinë	400,000	600,000	500,000
6	Dizajnimi dhe ndërtimi i Muzeut të Paqes	400,000	600,000	500,000
7	Dizajnimi dhe Rikonstruktimi i objektit të Kino Rinisë	500,000	2,000,000	2,000,000

Sqarim : Drejtorja e Kulturës në bashkëpunim me Ministrin e Kulturës, do të bëjnë projektin "Ndërtimi i Sallës Koncertale"

Drejtorja e Bujqësisë

Deklarata e misionit: Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka kjo drejtori, janë:

- hartimi i politikave për zhvillimin e bujqësisë;
- bashkëpunimi me MBPZHR-në;
- koordinimi i punëve me OQ dhe OJQ, vendore dhe ndërkombëtare;
- grumbullimi i shënimeve të sakta dhe me kohë për të gjitha fushat e bujqësisë, përgatit planet për mbjelljet vjetore dhe siguron që këto plane të implementohen;
- zhvillimi i ekonomik, i harmonizuar sipas standardeve dhe praktikave të BE-së, duke respektuar politikat e zhvillimit rural (PZHR) të BE-së, normat ekologjike dhe konkurruese me vendet e rajonit dhe i mbështetur nga fondet zhvillimore qeveritare, lokale dhe ndërkombëtare;
- subvencionimi në forma të ndryshme të qytetarëve, të cilën i përkasin fushave të ndryshme të bujqësisë.

Deklarata e qëllimit: Drejtorja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke u bazuar në planifikimin e buxhetit, në Planin e punës, në kërkesat e qytetarëve, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat përkatëse vendore dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me MBPZHR, realizon aktivitete dhe projekte, ku nëpërmjet subvencioneve, granteve të ndryshme dhe këshillave ndihmon fermerët dhe ekonomitë bujqësore në rritjen e produktivitetit për sektorët parësor të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

	Bujqësia	2024	2025	2026
1	Ndërtimi i Thertores publike dhe Tregu i kafshëve	2,000,000	1,000,000	500,000
2	Ndërtimi i Tregut mobil për prodhuesit vendorë nëpër pjesë të ndryshme të kryeqytetit	100,000	-	-
3	Ndërtimi dhe zgjerimi i kapaciteteve për ujitjen e tokave bujqësore	100,000	-	-
4	Urban Farming	300,000	200,000	-

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Deklarata e misionit: Mbrojtja dhe Shpëtimi i njerëzve, kafshëve, pasurisë, trashëgimisë së kulturës dhe ambientit ku jetojmë dhe veprojmë, nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Deklarata e vizionit: Sistemi i mbrojtjes dhe shpëtimit përmban programimin, planifikimin, organizimin, aftësimin, koordinimin, realizimin, mbikëqyrjen dhe financimin e masave, si dhe të aktiviteteve për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Deklarata e qëllimit: Detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera janë:

- zbulimi, përcjellja dhe hulumtimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
- vështrimi, lajmërimi, alarmimi dhe informimi i publikut për rreziqet e mundshme dhe dhënia e udhëzimeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë; - arsimimi dhe aftësimi për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
- organizimi i mbrojtjes dhe gatishmërisë emergjente, si dhe mënyrat tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
- vetëmbrojtja, ndihma, ndihma reciproke;
- aktivizimi i forcave për mbrojtje dhe shpëtim dhe i mjeteve për realizimin e masave mbrojtëse;
- evitimi i pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, deri te sigurimi i kushteve elementare për jetë;
- mbikëqyrja e përhershme rreth realizimit të rregullave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera;
- vetëdijësimi i qytetarëve për parandalimin e rreziqeve të shkaktuara nga zjarret dhe fatkeqësitë tjera;
- projektet për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera (rrëshqitja e dheut, vërshimet, ortekët e dëborës, fatkeqësitë teknologjike etj.);
- pajisjet e nevojshme të ekipeve për mbrojtje dhe shpëtim pranë Kuvendit të Komunës; trajnimi i stafit të drejtorisë, si dhe ekipeve për mbrojtje dhe shpëtim pranë Kuvendit.

	DSHP	2024	2025	2026
1	Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik	800,000	2,500,000	1,000,000
2	Ndriçim sinjalizues për vendkalime për siguri; Ndërtimi dhe modernizimi i semaforëve; Shtyllat antiparking dhe pistonat lëvizëse	300,000	1,000,000	300,000
3	Ndërtimi dhe funksionalizimi i kontejnerëve nëntokësor dhe gjysmë-nëntokësor	3,000,000	5,000,000	2,500,000
4	Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve në qytet	400,000	400,000	200,000
5	Projekti i vendosjes së kamerave të qytetit	400,000	1,300,000	200,000
6	Ri-dizajnimi dhe ndërtimi i fontanave në qytet	300,000	500,000	200,000

7	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	300,000	400,000	200,000
8	Fasadimi i ndërtesave të vjetra në kryeqytet	1,250,000	750,000	-
9	Mobilieri urbane dhe ndërtimi i rrethojave për siguri në mobilitet;	800,000	800,000	200,000
10	Trajtimi i mbeturinave ndërtimore (deponive ilegale)	200,000	300,000	100,000
11	Ndërtimi i tualeteve publike në qytet	300,000	500,000	200,000

Sqarim: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencave në bashkëpunim me MPB –Policinë, do të bëjnë projektin " Vendosi e kamerave të qytetit".

Drejtoria e Pronës

Deklarata e misionit: Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka:

- menaxhon me pronën në pronësi komunale;
- mban shënime për tokën dhe objektet në pronësi të Komunës;
- zhvillon procedurën e shpronësimit të tokës në pronësi private dhe shoqërore për ngastrat e planifikuara për interes publik sipas planeve urbanistike të Komunës;
- përgatit vendimet e shpronësimit për personat fizikë dhe juridikë;
- arrin marrëveshje dhe nënshkruan kontrata, me anë të së cilave siguron tokën e nevojshme për realizimin e interesit publik;
- nxjerr vendime për regjistrimin e të drejtës së pronësisë në emër të Komunës, në paluajtshmëritë e mbetura pa pronar;
- trajton dhe zhvillon procedurën administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës;
- nxjerr vendimet për lirimin e pronës komunale të uzurpuar arbitrarisht;
- shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave fizikë dhe juridikë në procedurë administrative, për rregullimin e marrëdhënieve pronësore – juridikë lidhur me pronën komunale;
- zhvillon procedurat administrative, sipas detyrës zyrtare, për ruajtjen e pronës komunale dhe interesit tjetër komunal;
- bën identifikimin dhe matjet gjeodezike në bazë të kërkesës së drejtorive për realizimin e projekteve komunale;
- përpunon konkluzionet pas plotfuqishmërisë së vendimit në procedurë administrative dhe pronësore – juridike;
- përgatit inicimin e procedurës për kallëzim penal, së bashku me përfaqësuesin juridik të Komunës, lidhur me uzurpimet arbitrare të pronës komunale;
- përcjell vendimet që kanë të bëjnë me shpronësimet për publikim në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave

Deklarata e misionit: Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka:

- harton programin zhvillimor afatgjatë dhe afatmesëm të infrastrukturës në nivel të komunës, në përputhje dhe në bashkëpunim me bashkësitë lokale dhe në harmoni me zhvillimin urbanistik të vendbanimeve dhe viseve rurale;
- përcjell dhe studion rrjedhat e zhvillimit të infrastrukturës së komunës dhe cakton kriteret e ndërtimit të infrastrukturës rrugore;
- përgatit detyrat projektuese dhe bën kategorizimin e objekteve të infrastrukturës lokale dhe rurale.

Deklarata e qëllimit:

- Harton projektet e vogla të infrastrukturës, sipas kërkesave të bashkësive lokale;
- lëshon leje për ndërtim (të infrastrukturës rrugore) dhe leje për gropim dhe hapje të kanaleve, të cilat i bëjnë ndërmarrjet publike, si dhe leje për kyçje individuale të qytetarëve në rrjetin e infrastrukturës;
- është përgjegjëse për menaxhimin (mbikëqyrjen) e ndërtimit, rindërtimit dhe sanimit të infrastrukturës rrugore (kanalizimet fekale, atmosferike, kabllore, ujësjellësin, asfaltimin, ndriçimin publik, sinjalizimin horizontal dhe vertikal) në qytet dhe vise rurale;
- kontrollon dhe mbikëqyrë cilësinë dhe ngjeshmërinë e materialit ndërtimor, nëpërmjet laboratorit të licencuar për përputhshmërinë me norma teknike të pranura në nivel ndërkombëtar dhe të BE;
- bashkëpunon me organin e prokurimit, me qëllim të jetësimit të kontratave të nënshkruara për kryerjen e punimeve të infrastrukturës lokale;
- kryen punë nga lëmi i gjeodezisë për nevoja të Drejtorisë;
- ruan dokumentacionin e ekspropriimit të pronave gjatë viteve të mëhershme që janë në interes të Komunës;
- arkivon dokumentacionin teknik të infrastrukturës lokale.

	DIKMK	2024	2025	2026
1	Ndërtimi i urave dhe mureve mbrojtëse në zonën urbane dhe rurale të kryeqytetit	1,500,000	2,000,000	2,200,000
2	Ndërtimi i rrugës "B", faza III.	2,000,000	-	-
3	Ndërtimi i rrugës "B", faza I	500,000	-	-
4	Ndërtimi i kolektorëve në Fshatin Hajvali.	1,000,000	500,000	500,000
5	Ndërtimi i rrugicave në fshatin Vranidoll dhe Tenezhdoll	250,000	200,000	-
6	Rruga lidhëse Kolovicë- Sofali	1,000,000	-	-
7	Rikonstruimi i Rr. "Qëndresa"	300,000	-	-

8	Rikonstruktimi i rrjetit të rrugëve brenda zonës urbane	2,500,000	1,500,000	950,000
9	Ndërtimi i krahëve të Rr. "Muharrem Fejza" sipas Planit rregullues	1,000,000	-	-
10	Realizimi i projektit rruga "A".	8,000,000	8,000,000	10,000,000
11	Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik në fshatrat e komunës së Prishtinës.			
12		1,500,000	900,000	900,000
13	Rikonstruktimi i rrugës "Nekibe Kelmendi" faza e dytë	600,000	400,000	-
14	Rikonstruktimi i rr. "Qamil Hoxha", Rr. "Sylejman Vokshi" dhe rr. "Hajdar Dushi".	1,500,000	1,000,000	-
15	Ndërtimi i rrugëve në Bardhosh	250,000	250,000	-
16	Ndërtimi i rrugëve në Barilevë, Prugovc, Lebanë dhe Rmianishtë	500,000	400,000	-
17	Ndërtimi i nënkalimit për vetura në rrugën "Agim Ramadani"	4,000,000	1,500,000	-
18	Platforma ndërlidhëse e Arbërisë me Pallatin e Rinisë	500,000	2,500,000	3,500,000
19	Ndërtimi i rrugës në Lagjen e Muahxhirëve	1,000,000	500,000	-
20	Sheshi historik i Prishtinës	-	1,000,000	1,500,000
21	Ndërlidhja e zonës "Qendra" me lagjet përreth, përmes platformave të gjelbra dhe shtigjeve të transportit alternativ.	2,000,000	5,000,000	5,000,000
22	Ndërtimi i nënkalimit për lëvizjen e veturave nga rrethi i Veternikut deri tek Stacioni i Autobusëve.	7,500,000	7,500,000	-
23	Ndërtimi i Unazës së Qytetit	101,000,000	100,000,000	50,000,000
24	Ndërtimi i Unazës Qendër të Qytetit, nga Arbëria në drejtim të Kodrës së Trimave	2,500,000	-	-
25	Ndërtimi i rrugës Veternik-Hajvali, duke u lidhur me rajonin e Gollakut dhe Anamoravës.	1,000,000	1,000,000	-
26	Ndërtimi i rrugës "Bajram Bahtiri", Llukar, Makovc deri në Grashticë.	1,000,000	1,000,000	-
27	Ndërtimi i rr. "Ilaz Agushi", nga gjimnazi "Sami Frashëri" në drejtim të Tregut të gjelbër.	1,000,000	-	-
28	Ndërtimi i mbikalimit tek Stacioni i trenit, i cili lidhet me Pallatin e Rinisë.	1,000,000	1,000,000	-
29	Ndërtimi i 430 vendparkimeve të reja në lagjen "Ulpiana", në formë të dis-nivelit, duke ruajtur gjelbërimin lart tij.	2,500,000	2,500,000	-
30	Përfundimi i parkingut nëntokësor tek AKP-ja, duke e zhvendosur Tregun e gjelbër mbi sipërfaqen e parkingut.	1,000,000	1,000,000	-

31	Ndërtimi i parkingut për automjete përmes unazës së brendshme të zonës Qendër, që përfshin rrugën “Agim Ramadani”, Bulevardi “Bill Clinton”, rruga “Tirana” dhe rruga e UÇK-së.	500,000	-	-
32	Ndërtimi i parkingut nëntokësor te Posta qendrore, duke e ruajtur gjelbërimin lart.	-	2,000,000	-
33	Ndërtimi i parkingut nëntokësor në lagjen “Dardania”.	3,000,000	-	-
34	Ndërtimi i nënkalimit që lidh “Rrethin e Flamurit” me rrethin e QKUK-së, i cili do të ketë të integruar edhe një parking nëntokësor të hyrja e qytetit në zonën në mes tre rrathëve.	1,000,000	2,500,000	2,000,000
35	Nënkalim për vetura në pjesën nga Katedralja në drejtim të Fakultetit të Filologjisë.	-	2,000,000	2,500,000
36	Investime në rrjetin e ujësjellësit brenda zonës urbane dhe në një pjesë të madhe të fshatrave të Gollakut	500,000	1,000,000	-
37	Ndërtimi i parkut të qenve, të ngjashëm me Parkun e Arinjve, në të cilin do të strehohen qentë endacakë.	1,000,000	2,000,000	2,000,000
38	Ndërtimi i infrastrukturës për dyfishim të kapaciteteve prodhuese dhe rrjetit transmetues të kogjenerimit nga 140 MWt – 280 MWt.	25,000,000	15,000,000	10,000,000
39	Përgatitja e infrastrukturës në qytet për makina elektrike.	-	500,000	600,000
40	Ndërtimi i shtresës finale të rrugës Stallov - Zllashë	800,000	-	-
41	Ndërtimi i rr. “Holger Petersen” - faza II	1,000,000	500,000	-
42	Zhavorrimi I rrugëve në fshatrat e Komunës së Prishtinës	600,000	500,000	-
43	Intervenime emergjente zonale në Komunën e Prishtinës	2,500,000	2,500,000	2,500,000
44	Intervenimet për eliminimin e barrierave për personat me nevojë të veçanta	500,000	500,000	-
45	Ndërtimi i rrugëve në fshatrat e Gollakut	1,000,000	1,000,000	-

Sqarim -Projektet si :

- 1 Ndërtimi i Unazës së Qytetit;
- 2 Ndërtimi i rrugës Veternik-Hajvali, duke u lidhur me rajonin e Gollakut dhe Anamoravës;
- 3 Ndërtimi i mbikalimit tek Stacioni i trenit, i cili lidhet me Pallatin e Rinisë;
- 4 Ndërtimi i 430 vendparkimeve të reja në lagjen “Ulpiana”, në formë të dis-nivelit, duke ruajtur gjelbërimin lart tij;
- 5 Përfundimi i parkingut nëntokësor tek AKP-ja, duke e zhvendosur Tregun e gjelbër mbi sipërfaqen e parkingut;
- 6 Ndërtimi i parkingut nëntokësor në lagjen “Dardania”;
- 7 Ndërtimi i nënkalimit që lidh “Rrethin e Flamurit” me rrethin e QKUK-së, i cili do të ketë të integruar edhe një parking nëntokësor;
- 8 Ndërtimi i parkingut nëntokësor te Posta qendrore, duke e ruajtur gjelbërimin lart.
Ndërtimi i parkingut për automjete përmes Unazës së Brendshme të zonës “Qendër” që përfshin rrugën “Agim Ramadani”, Bulevardit “Bill Clinton”, rruga “Tirana” dhe rruga e UÇK-së.
- 9

- 10 Ndërtimi i Parkut të qenve, të ngjashëm me Parkun e arinjve, në të cilin do të strehohen qentë endacakë;
- 11 Ndërtimi i infrastrukturës për dyfishim të kapaciteteve prodhuese dhe rrjetit transmetues të kogjenerimit nga 140 MWt – 28
- 12 Përgatitja e infrastrukturës në qytet për makina elektrike.

Projekti : numër 1 do të behet në bashkëpunim mes Kryeqytetit dhe EBRD - Ministria e Infrastrukturës;
numër 2 do të bëhet në bashkëpunim mes Kryeqytetit dhe Ministrisë së Infrastrukturës;
numër 3 do të bëhet në bashkëpunim mes Kryeqyteti dhe Ministrisë së Kulturës;
numër 4 deri numrin 9 do të behën me PPP-NPL" Prishtina Parking ";
numër 10 do te behet me PPP
do të bëhet mes Kryeqytetit dhe ndërmarrjes "Termokos" -KEK-
Numër 11 KFW
Numër 12 do të bëhet në mes Kryeqyteti dhe ndërmarrjes "Trafikut Urban"

Drejtoria e Menaxhimit të Parqeve dhe Hapësirave Publike

Drejtoria e Menaxhimit të Parqeve kryen këto detyra:

Deklarata e misionit :

Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të Drejtorisë së Parqeve përfshihen:

- Krijimi dhe administrimi i parqeve rekreative brenda territorit të komunës së Prishtinës;
- Evidentimi i zonave të përshtatshme për krijimin e hapësirave të reja të gjelbra në secilën zonë të kryeqytetit;
- Mbrojtja dhe kujdesi ndaj zonave të gjelbra brenda territorit të komunës së Prishtinës;
- Administrimi i aseteve rekreative (pajisje, pista e shtigje, ambiente rekreative) që ndodhen në territorin e komunës së Prishtinës);
- Krijimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e këndeve të lojërave për fëmijë;
- Nxitja, promovimi, mbështetja dhe organizimi i aktiviteteve rekreative për fuqizimin e jetesës aktive nëpërmjet edukimit e sensibilizimit për një jetesë të shëndetshme, në bashkëpunim me sektorë të tjerë përgjegjës;
- Organizimi dhe koordinimi i planeve operationale të gjelbërimit;
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave të parqeve për aktivitete kulturore (jo afariste);
- Informimi i publikut për çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe mbrojtjen e hapësirave të gjelbra;
- Emërtimi i secilës prej hapësirave të gjelbra brenda territorit të komunës së Prishtinës;
- Bashkërendimi me dikasteret tjerë të nivelit lokal dhe ministrinë e linjës mbi çështje që lidhen me hapësirat e gjelbra.

	Parqet	2024	2025	2026
1	Parqet dhe hapësirat e reja publike/rekreative në zonat urbane dhe rurale në komunën e Prishtinës. Lidhja e zonave të gjelbra përmes krijimit të korridoreve të gjelbra brenda territorit të komunës së Prishtinës (ndërtimi i parqeve).	1,000,000	1,200,000	1,000,000
2	Shtrirja e sistemit të ujitjes në parqet dhe hapësirat e komunës së Prishtinës	300,000	400,000	500,000
3	Furnizimi me fidanë dhe shkurre shumëvjeçare për hapësirat e qytetit dhe parqet (pyllëzimi urban)	400,000	500,000	550,000
4	Ndërtimi dhe mirëmbajtja e këndeve publike të lodrave	500,000	600,000	800,000
5	Parku Botanik	500,000	-	-

Drejtoria e Sportit dhe Rekreacionit

Drejtoria e Sportit dhe Rekreacionit kryejnë këto detyra:

- Bashkëpunon ngushtë dhe për punën e vetë i raporton Kryetarit të Komunës;
- Harton planin për mbështetjen sportive dhe rinore;
- Udhëheq me resurset lokale rinore dhe sportive;
- Udhëheq me terrenet e sporteve dhe hapësirat tjera përcjellëse;
- Organizon debate për zhvillim dhe avancim e rinisë dhe sportit;
- Grumbullon shënime faktike mbi të arriturat në rini dhe sport;
- Bashkëpunon me nivelin qendror në fushë-veprimtarinë përkatëse dhe këshilltarët nga këto fusha;
- Bën regjistrimin e grupeve, klubeve etj.;
- Mbështet aktivitetet rinore dhe sportive;
- Bashkëpunon me qytete tjera, për të mundësuar një integrim të mirëfilltë dhe këmbim përvojash me organizata të tjera vendore e ndërkombëtare;
- Përkrahë dhe ndihmon asociacione, klube dhe shoqata në aktivitetet e tyre;
- Organizon anketa, seminare e trajnime të ndryshme, kycje të të rinjve kosovarë në aktualitete rinore, evropiane e botërore;
- Ushtron edhe kompetenca të tjera që do t'i përcaktohen me ligj ose që delegohen nga pushteti lokal apo bashkëpunim me nivelin qendror.

	Sporti	2024	2025	2026
1	Ndërtimi i terreneve dhe hapësirave sportive në komunën e Prishtinës dhe renovimi i atyre ekzistuese	250,000	150,000	150,000
2	Ndërtimi i tribunës KF "Ramiz Sadiku"	200,000	-	-

3	Finalizimi i tribunës KF "2 Korriku"	100,000	-	-
4	Ndërtimi i tribunës KF "Rilindja"	200,000	100,000	-
5	Ndërtimi i Sallës Multifunkionale	2,000,000	2,000,000	3,000,000
6	Ndërtimi i shtigjeve për vrapim	100,000	50,000	50,000
7	Ndërtimi i tualeteve dhe dhomave të zhveshjes në fushat e futbollit të FC "Prishtina" dhe KF "Kosova e Prishtinës" në Bërnice	100,000	-	-
8	Intervenimet infrastrukturore dhe funksionalizimi i fushave sportive në Bardhosh, Barilevë, Matiçan dhe Bërnice	100,000	-	-
9	Ndërtimi i fitneseve natyrore në parqe dhe kënde strategjike të Prishtinës, me pajisje që i rezistojnë natyrës	100,000	50,000	-
10	Riparimi i fushave të sportit në lagjen "Kodra e Trimave"	50,000	50,000	-
11	Ndërtimi i fushave të tenisit	100,000	100,000	-
12	Ndërtimi i Tribunës KF "Flamurtari"	100,000	-	-
13	Ndërtimi i patinazhit të qytetit	100,000	-	-

Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencave

Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencave në kuadër të kompetencave, autorizimeve dhe përgjegjësisë ligjore, përkujdeset për aspektin e sigurisë në pjesët urbane dhe rurale të Kryeqytetit, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, bashkësitë lokale dhe Forumet e Sigurisë në Bashkësi.

- Bën hartimin dhe azhurnimin e planeve dhe projekteve nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, në pajtim me ligjet dhe udhëzimet administrative nga niveli qendror dhe lokal;
- Ndërmerr masa parandaluese për pengimin, zvogëlimin dhe eliminimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera;
- Bën zbatimin efektiv të akteve të nxjerra nga Kryetari i Kryeqytetit dhe Kuvendit komunal, që kanë të bëjnë me sigurimin e rendit dhe qetësisë dhe mbarëvajtjen e punëve publike;
- Reagon ndaj situatave të shkaktuara dhe ndërmerr masa mbrojtëse, sanon gjendjen e shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe siguron kushtet elementare për jetë;
- Organizon formimin e njësive vullnetare të zjarrfikësve dhe njësive tjera për raste nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në bashkëpunim me BPZ-në;
- Përkujdeset për sigurimin e ngjarjeve të ndryshme kulturore, sportive e të natyrave tjera në Kryeqytet;

- Kujdeset për funksionimin e sistemin të alarmit publik në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, testimin e tyre;
- Pranon informata nga qytetarët dhe institucionet tjera komunale në Qendrën e thirrjeve 0800 122 33 dhe 0800 122 44, përpunon ato dhe dërgon në kohën sa më të shpejtë dhe efikase për personin apo institucionin që i dedikohen këto informata 24/7;
- Në rastet emergjente, i propozon Kryetarit të Komunës shpalljen e gjendjes emergjente, dhe propozon ndërmarrjen e masave për përballimin e situatës;
- Menaxhon projektet nga fusha e Sigurisë dhe Emergjencave;
- Mobilizon dhe aktivizon mekanizmat, strukturat dhe potencin reagues për mbrojtje dhe shpëtim, angazhimi i kompanive komunale, kompanive të kontraktuara nga Komuna dhe kompanive tjera për intervenime emergjente në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera;
- Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, ofron sigurinë e nevojshme për shkollat fillore dhe të mesme, objektet komunale dhe objektet me rëndësi të veçantë;
- Merr masa për ruajtjen e pasurisë së Komunës, si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj;
- Përkujdeset për sigurinë e komuniteteve të ndryshme, përfshirë ato etnike, duke bashkëpunuar ngushtë me Policinë e Kosovës dhe Forumet e Sigurisë në Bashkësi (Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, këshillat lokalë për Siguri Publike dhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi);
- Përkujdeset për sigurinë e drejtorive, në veçanti atyre që u shërbejnë drejtpërdrejtë qytetarëve;
- Në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, merret me evakuimin dhe strehimin e qytetarëve nga zona e rrezikut;
- Kujdeset për mirëmbajtjen dhe funksionalizimin e strehimoreve publike;
- Bën regjistrimin dhe inspektimin e objekteve të vjetra, zonave dhe objekteve tjera me rrezikshmëri të lartë dhe objekteve nën Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe jep pëlqimin për rrënimin e objekteve të vjetra të cilat rrezikojnë jetën e qytetarëve;
- Bashkëpunon me Institucionet tjera të sigurisë dhe emergjencës: Forcën e Sigurisë së Kosovës, Policinë e Kosovës, AME, BPZ, KFOR-in;
- Ofron siguri sipas nevojës dhe kërkesës në çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e Kryeqytetit, apo që nuk i është përcaktuar ndonjë autoriteti tjetër;
- Sipas nevojës dhe kërkesës, ofron siguri edhe për aktivitetet në fushën e kompetencave të deleguara, sipas nenit 17 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale.